



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.29.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Liridona Berisha-Kelmendi Udhëheqëse e ekipit dhe Senver Morina anëtar i ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	18
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	19
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	22
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetorë të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 17/04/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryesuesit dhe Drejtorit - auditimi 2016

Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil kanë marrë në konsideratë dhe janë pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e AAC-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiarë nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit të AAC-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AAC-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AAC kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Pajtueshmërinë me rregullën Financiare nr. 03/2010;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi çështje për të ngritur. Andaj Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e plotë dhe e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur e PFV-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AAC-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga AAC siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në AAC në lidhje me raportimin menaxherial, llogaridhënien si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. AAC-ja gjatë vitit 2016 ka marrë veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të AP-së. Ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 të AAC-së kishte rezultuar me dy (2) rekomandime kryesore. AAC kishte përgatitur një Plan Veprimi për mënyrën e zbatimit të tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, një (1) rekomandim ishte zbatuar dhe një (1) ishte në proces të zbatimit. AAC-ja ka bërë përpjekjet e saj për zbatimin e tij. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AAC-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij, dhe kemi vërejtur se AAC:

- Për pyetjet e shqyrtuara kemi vërejtur se në përgjithësi proceset e vendosjes së objektivave strategjike konsiderohen si të vendosura nga AAC-ja. Dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të plota;
- Çështjet e raportimit janë të vendosura në bazë javore, mujore, tre mujore dhe vjetore; dhe
- Ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, duke e hartuar planin detaj për trajtimin e rreziqeve të organizatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AAC operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti i AAC-së ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Në organogramin e AAC-së janë të paraqitura qartë struktura organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. AAC-ja ka një raportim të mirë financiar mbi të hyrat, shpenzimet dhe realizimin e buxhetit duke aplikuar proceset e llogaridhënies dhe të raportimit në baza javore, mujore dhe tremujore.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB), AAC nuk i plotëson kriteret për themelimin e saj. Në mungesë të NjAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF). Në planin vjetor të DAB për 2016 nuk ishte e përfshirë AAC-ja.

Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm, të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, të hyrat, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë, të arkëtueshmet dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AAC në përgjithësi ka kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të procesit buxhetor marrë si tërësi janë të mira. Gjatë vitit 2016, AAC ka arritur të realizoj pothuajse 100% të buxhet final.

Auditimi ynë i këtij viti nuk ka identifikuar ndonjë mangësi domethënëse në menaxhimin e përgjithshëm të shpenzimeve. Megjithatë nevojiten përmirësime në disa fusha, si në: procesin e të hyrave, dhe menaxhimin e pasurive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për AAC-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtueshme. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës - ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,515,000 ²	1,515,000	1,719,938	1,539,500	1,368,546
Totali	1,515,000	1,515,000	1,719,938	1,539,500	1,368,546

Të hyrat e mbledhura nga AAC deponohen në Buxhetin e Kosovës.

² Plani i rrjedhës së parasë së AAC-së për vitin 2016.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore-realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Burimet e Fondeve:	925,274	832,556	832,147	824,469	822,116
Granti i Qeverisë-Buxheti	921,145	828,427	828,018	817,731	822,116
Donacionet e jashtme ⁴	4,129	4,129	4,129	6,738	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte më i ulët për 92,718€. Kjo është si rezultat i kursimeve buxhetore në bazë të vendimeve të Qeverisë. Në vitin 2016, AAC ka përdorur 99.95% të buxhet final ose 832,147€, me një rritje prej 9% krahasuar me vitin 2015.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ⁵	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	925,274	832,556	832,147	824,469	822,116
Pagat dhe mëditjet	688,484	625,223	625,223	622,980	594,457
Mallrat dhe shërbimet	223,052	200,339	200,339	194,478	220,039
Shërbimet komunale	13,738	6,994	6,585	7,011	7,619

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në kategorinë paga dhe mëditje AAC-së i është shkurtuar buxheti për 63,261€ me vendim të Qeverisë në fund të vitit;
- Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti final ishte reduktuar për 22,713€. Fillimisht me vendim të Qeverisë ishte reduktuar për 28,842€. Ndërsa me pas ishte rritë për 6,129€ (donacioni i pranuar gjatë vitit 2015, i bartur në vitin 2016 në vlerë prej 4,129€ dhe transferimi nga shpenzimet komunale në vlerë 2,000€); dhe
- Në kategorinë e shpenzimeve komunale AAC-së i është shkurtuar buxheti për 6,744€ (me vendim të Qeverisë⁶ 4,744€ dhe transferi prej 2,000€ i bërë në mallra dhe shërbime).

³ Buxheti Final-buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁴ Donacion nga Komisioni Evropian për projektin Dizajnimi i procedurave të fluturimit përmes sinjalit satelitor është pranuar gjatë vitit 2015. Pjesa e mbetur në vlerë prej 4,129,43€ është bartur në vitin 2016.

⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁶ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 11/120 i datës 14,12,2016 dhe vendimi me nr 01/123 i datës 28,12,2016

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga AAC-ja në 2016 ishin në vlerë 1,715,809€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tarifa e sigurisë së pasagjerëve, të hyrat nga tarifat e certifikimit dhe licencimit dhe gjobat tjera. Ne kemi ekzaminuar 44 mostra, testimi ynë ka nxjerr në pah çështjen e paraqitur në vijim.

Çështja 1 - Lëshimi i certifikatës pa përmbushjen e obligimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullores nr. 02/2015 për tarifat e ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, AAC-ja do të kërkojë që 50% e tarifës së caktuar t'i paguhet me rastin e dorëzimit të aplikacionit, ndërsa pjesa e mbetur prej 50% para lëshimit përfundimtar apo ripërtëritjes së certifikatës. Ndërsa secila faturë e AAC-së duhet të paguhet brenda periudhës prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të saj. Dështimi për të paguar faturën në kohën e duhur, rezulton me pezullim të shqyrtimit të lëndës.

AAC-ja ka shqyrtuar aplikacionin dhe ka lëshuar certifikatën për ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror, në këtë rast për Autoritetin për Shërbimet e Navigacionit Ajror (ASHNA) pa i kryer obligimet. Tarifa (pjesa e parë) për këtë certifikatë është 10,000€ e cila ishte dashur të paguhet brenda 15 ditëve. Kjo tarifë është paguar pas pranimit të certifikatës, me vonesë prej nëntë (9) muaj e gjysmë. Ndërsa pagesa e dytë ishte kryer me vonesë prej 43 ditë. Lëshimi i certifikatës nuk ishte në harmoni me rregulloren nr. 02/2015 për tarifat e ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës. Pasi ASHNA i ka plotësuar kushtet tjera, përveç pagesës dhe për shkak të rëndësisë që ka ky institucion, AAC ka marrë veprimin për pajisje me certifikatë.

Rreziku Mos menaxhimi i mirë i procesit për lëshimin e certifikatës për ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror tregon jo efikasitetin e organizatës në zbatimin e procedurave/kërkesave dhe bartë në vete rrezikun për rritjen e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori Përgjithshëm duhet të sigurojnë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me lëshimin e certifikatave. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që certifikatat të lëshohen vetëm pasi të kryhen obligimet, sipas kërkesave të rregullores.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë në pajtim me aktet e emërimit si dhe legjislacionit të aplikueshëm

Numri i aprovuar për të punësuarit në AAC ishte 30, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2016 ishte 24 (23 punonjës me orar të plotë dhe 1 punonjës me orar të shkurtuar). Ne kemi testuar listat e pagave (përfshirë dosjet e personelit) dhe prezantimin e tyre në PFV-të.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime duke përfshirë edhe shërbimet komunale në vitin 2016 ishte 207,333€. Prej tyre janë shpenzuar 206,924€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet përmes procedurave të prokurimit dhe ato shpenzime për të cilat nuk aplikohen procedurat e prokurimit (komunalit, avanset, shpenzimet e telefonisë mobile, etj.) AAC gjatë vitit 2016 kishte nënshkruar pesë (5) kontrata në pajtueshmëri me LMFPF-në si dhe LPP-në. Prej vitit 2016 procedurat e prokurimit për AAC kanë kaluar në përgjegjësinë e Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV vlera neto e pasurive ishte 12,555€. Prej tyre 5,074€ ishte vlera e pasurive jokapitale (nën 1,000€), ndërsa 7,481€ vlera e stoqeve. Vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) ishte zero si rezultat i zhvlerësimit të pasurive. Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi çështjen si në vijim.

Çështja 2 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** AAC-ja nuk kishte menaxhuar pasuritë e veta në përputhje me kërkesat e rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.
- Regjistri kontabël i pasurive nuk përmbante të gjitha elementet e kërkuara si: numrin serik, lokacionin, burimin e financimit, zhvlerësimin e vitit të tanishëm dhe zhvlerësimin e akumuluar. Kjo gjë e vështirëson identifikimin se si është kalkuluar zhvlerësimi për vitin.
 - Blerja e pasurive për vitin 2016, në vlerë prej 9,057€ nuk ishte regjistruar në regjistrin e përgjithshëm të pasurisë në AAC; dhe
 - Regjistri e-pasuria për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€ nuk është funksional në AAC.
- Rreziku** Kontrollat e dobëta në menaxhimin e pasurisë ndikojnë menaxhim jo efikas si dhe rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori Përgjithshëm duhet t'i rishikojnë kontrollat ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas dhe regjistrimin e gjithë pasurisë që të ruhen nga humbja apo keqpërdorimi. Në këtë aspekt të ndërmerren veprime për funksionalizimin e regjistrit e-pasuria.

3.2.2 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e imët janë fond i vogël i parave që mbahet nga organizatat buxhetore që shfrytëzohen për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël.

Çështja 3 – Avansi nuk ishte mbyllur me kohë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Organizatat buxhetore të gjitha avanset dhe paratë e imëta të lëshuara gjatë vitit fiskal duhet t'i mbyllin deri me datën 27 dhjetor të vitit fiskal. AAC në PFV kishte të pa mbyllur avansin për paranë e imët në vlerë prej 1,000€, si e tillë figuron edhe në SIMFK. Si rrjedhojë nuk janë zbatuar kërkesat e rregullës financiare nr. 10-2012 për mbylljen e vitit fiskal. Edhe pse AAC kishte bërë kërkesën për mbylljen e avansit të parasë së imët në MF kjo nuk është bërë, ndërsa me vendim të Qeverisë⁷ për kursime buxhetore kjo shumë është marrë AAC-së.

⁷ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 1/123 i datës 28,12,2016

- Rreziku** Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun që paraja publike të përdoret në mënyrë të parregullt nga persona të caktuar.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori Përgjithshëm duhet të rishikojnë kontrollet ekzistuese në lidhje me mbylljen e avanseve për paranë e imët për të siguruar mbylljen e tyre sipas afateve të përcaktuara.

3.2.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme janë obligime të klientëve të papaguara ndaj AAC. Gjendja e llogarive të arkëtueshme sipas PFV ishte 240,426€. Shumën e llogarive të arkëtueshme e përbëjnë: tarifa e sigurisë së pasagjerëve (të cilat mblidhen sipas marrëveshjes në mes të Koncesionit 'LIMAK Kosovo Adem Jashari' dhe AAC), gjoba etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në PVF në fund të vitit 2016 ishte 1,973€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Ne kemi kryer teste lidhur me obligimet në fund të vitit si dhe ato të raportuara në raportet mujore. Bazuar në këtë shpalosim mangësitë si në vijim.

Çështja 4 - Mos raportimi i plotë obligimeve të papaguar - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, organizatat buxhetore janë të obliguara që t'i raportojnë të gjitha obligimet e papaguara në MF.

AAC kishte raportuar tek MF në bazë mujore për obligimet e papaguara sipas afatit të paraparë. Mirëpo në raportin e muajit dhjetor nuk janë përfshirë të gjitha faturat, për shkak se janë pranuar pas raportimit të AAC-së në MF. Si rrjedhojë vlera e obligimeve të shpalosura në PFV nuk ishte e njëjtë me vlerën e raportit mujor të obligimeve për muajin dhjetor. Në PFV ishte shpalosur vlera 1,973€ si obligime ndërsa sipas raportit të muajit dhjetor obligimet ishin 946€, me diferencë 1,026€.

Rreziku Mos raportimi i rregullt i obligimeve të papaguara rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë. Njëkohësisht, ndaj Institucionit mund të paraqiten ndëshkimet për vonesat në pagesë.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit dhe Drejtori Përgjithshëm duhet që të ndërmarrin veprime të nevojshme për të siguruar raportim të drejtë të obligimeve të papaguara dhe të përcillen/monitorohen derisa të paguhen.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit/Drejtori duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.5 Menaxhimi i rrezikut	Rekomandimi 1: Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është ndërmarrë një analizë e hollësishme e rreziqeve të identifikuara duke bërë vlerësimin e tyre dhe të reaguarit ndaj këtyre rreziqeve për të ngritur efektivitetin e menaxhimit të rrezikut.	Po		
4.6 Pasuritë dhe detyrimet	Rekomandimi 2: Drejtori i Përgjithshëm të sigurohet që janë marrë masa shtesë duke ju përkujtuar poseduesve të pasurisë procedurat dhe kërkesat ligjore për shfrytëzim dhe kthimin e pasurisë.		Nga menaxhmenti i AAC-së janë ndërmarrë masa shtesë por kthimi i pasurisë edhe pas kësaj ende nuk është bërë.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

 Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo		<table border="1"> <tr> <td colspan="3">Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo</td> <td rowspan="2">CAA</td> </tr> <tr> <td colspan="3">Autoriteti i Aviacionit Civil / Autoriteti i Aviacionit Civil / Civil Aviation Authority of Kosovo</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Titulli i Dokumentit / Titulli i Dokumentit / Document Title</td> <td colspan="2">2017/BDP/22</td> </tr> <tr> <td>Fajti / Strana / Page</td> <td>Kopje / Kopje / Copy</td> <td colspan="2">Data / Data / Date</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Hyrje / Vazhdim / Start / End</td> <td colspan="2">Data / Data / Date</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Duke / Nuk / Yes / No</td> <td colspan="2">Pristina / Pristina / Pristina</td> </tr> </table>	Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			CAA	Autoriteti i Aviacionit Civil / Autoriteti i Aviacionit Civil / Civil Aviation Authority of Kosovo			Titulli i Dokumentit / Titulli i Dokumentit / Document Title		2017/BDP/22		Fajti / Strana / Page	Kopje / Kopje / Copy	Data / Data / Date		Hyrje / Vazhdim / Start / End		Data / Data / Date		Duke / Nuk / Yes / No		Pristina / Pristina / Pristina	
Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo			CAA																						
Autoriteti i Aviacionit Civil / Autoriteti i Aviacionit Civil / Civil Aviation Authority of Kosovo																									
Titulli i Dokumentit / Titulli i Dokumentit / Document Title		2017/BDP/22																							
Fajti / Strana / Page	Kopje / Kopje / Copy	Data / Data / Date																							
Hyrje / Vazhdim / Start / End		Data / Data / Date																							
Duke / Nuk / Yes / No		Pristina / Pristina / Pristina																							

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Dritan Gjonbaj 

Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil

Data: 9 qershor 2017, Prishtinë

ISO 9001:2015 CERTIFIED

Tel: +361 (0)38 248 629 | Fax: +361 (0)38 211 009 | info@caa-ks.org | www.caa-ks.org
Rruga Ahmet Krasniqi p.n. Lagje Arbëria | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës